



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

PROGRAMI: MENAXHIM BIZNESI (BSc.)

Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit:	Menaxhim Biznesi
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Arsimi i lartë – Cikli i parë i Bolonjës (Bachelor) BSc., Niveli i VI
Grada akademike (kualifikimi i fituar):	Bachelor i Shkencës në Menaxhim Biznesi (BSc.) Specializimet: 1. Administrim Biznesi; 2. Banka dhe Financa;
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC):	04.0
Kohëzgjatja minimale e studimit:	3 vite, 6 semestra
Forma e studimit:	Studime të rregullta
Numri i ECTS kredive:	Gjithsej 180 ECTS, për një vit 60 ECTS
Profili i programit akademik (specializimi):	1. Administrim biznesi në gjuhën shqipe dhe boshnjake. 2. Banka dhe Financa në gjuhën shqipe dhe boshnjake;
Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	Programi "Menaxhim Biznesi" ka për qëllim t'i përgjigjet nevojës së tregut të punës për personel të kualifikuar dhe kompetent. Studentët e diplomuar në këtë program do të kualifikohen për vet-punësim dhe për të qenë pjesë e udhëheqjes profesionale të një biznesi në kuadër të ekonomisë së tregut. Objektiv i këtij programi të studimeve themelore është të ofrojë edukim profesional në këtë fushë të rëndësishme të jetës sociale. Programi është i projektuar për të siguruar një njohuri të plotë në Menaxhim Biznesi. Programi synon lidhshmëri mes teorisë dhe praktikës që ofrojnë bazë solide për diversitetin e udhëheqjes së biznesit. Ky program ka për qëllim që të përkrahë dhe të kontribuojë në zhvillimin e kapaciteteve operuese të bizneseve private në regionin e Pejës dhe më gjerë. I bazuar në kërkesat aktuale të tregut, organizimi i programit të studimit është ndarë në dy module

	/ specializime: - Administrim Biznesi në gjuhën shqipe dhe boshnjake; - Banka dhe Financa në gjuhën shqipe dhe boshnjake; Programi ofron mundësi që studentët e diplomuar të jenë konkurrues në tregun e punës në rajonin e Dukagjinit dhe në tërë vendin në përgjithësi.
Rezultatet e pritshme të të nxënit:	Rezultatet e pritshme për studentin nga mësim-nxënja janë: - Fiton njohuri të përgjithshme dhe kupton konceptet kryesore, metodologjitë, qasjet teorike dhe supozimet në disiplinat e ndërlidhura me biznesin dhe menaxhmentin; - Zgjeron dituritë mbi konceptet e fushës së menaxhimit, financave dhe administrimit të biznesit; - Përfiton shkathtësi në aplikimin e sistemeve të informacionit dhe të kontabilitetit, përfshirë një qasje dhe perspective ndërdisiplinore; - Aftësohet për të mbledhur, rishikuar, vlerësuar dhe interpretuar informacionet e rëndësishme për një ose më shumë fusha kryesore në menaxhment dhe në biznes; - Përvetëson njohuri më të thella për aktivitetet biznesore; - Zhvillon të menduarit kritik dhe aftësitë analitike brenda disiplinës së ndërmarrësisë; - Demonstron përvojën e fituar teorike dhe praktike për të aplikuar të nxënit në gjenerimin e ideve kreative, krijimin e bizneseve të reja dhe udhëheqjes në lëmin e menaxhimit të biznesit;
Procedurat e mësimdhënies:	- Procesi mësimor mbahet nëpërmjet ligjëratave, ushtrimeve dhe ushtrimeve laboratike. Pothuajse të gjitha lëndët përmbajnë dhe punën kërkimore dhe dy teste gjatë kursit semestral. - Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 50 : 50. Në disa raste, sipas natyrës së lëndës dhe e paraparë me syllabus ky raport mund të jetë 60:40. - Gjithashtu studentet kanë hapësirë që të shprehin njohuritë e përgjithshme në praktikë në kuadër të lëndës "Praktika dhe Zhvillimi i Karrierës". Kjo lëndë është obligative dhe gjatë semestrit studentet janë të obliguar që të përfundojnë praktikën në institucione publike ose private. Aktiviteti rreth sigurimit të punës praktike për studentë dhe organizimi i punës për këtë çështje bëhet nga ana e Qendrës për Zhvillimin e Karrierës, UHZ. Mësimdhënia organizohet në bazë të kësaj metodologjie: - Ligjërata inter-aktive dhe prezantime në "Power Point" ose "Prezzi"; - Analiza të rasteve të studimit dhe shembuj nga praktika e bizneseve vendore dhe ndërkombëtare; - Diskutime dhe komunikim i hapur pedagog – student;

	- Ushtrime me shembuj konkretë nga fusha të ndryshme të ekonomisë; - Detyra që prezantohen dhe diskutohen nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor nën frymën e një bashkëveprimi produktiv dhe nën kushtet e një ambienti të favorshëm mësimi;
Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve);	Sipas nenit 104, 105, 106 të Statutit të UHZ, vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet me anë të testimit me shkrim dhe me gojë. Pjesa e vlerësimit dhe notimit të studentëve varet nga lënda dhe kriteret e përdorura në mënyrë individuale nga mësimdhënësi i lëndës. Studenti vlerësohet gjatë gjithë semestrit përmes testeve, punimeve seminarëve, pjesëmarrjeve në projekte, konferenca shkencore, etj. Metodat e vlerësimit përcaktohen në syllabuse të secilës lëndë mësimore veç e veç në kuadër të programit, Një shembull vlerësimi është si më poshtë: Pjesëmarrja aktive në mësim.....10% Detyrat, ushtrimet.....10% Testi i parë.....20% Testi i dytë.....20% Provimi përfundimtar.....40% Total 100% Gjersa, një shembull i kriterit të notimit është si në vijim: 0-50.99%(5) 51-60.99%(6) 61-70.99%(7) 71-80.99%(8) 81-90.99%(9) 91-100%(10)
Modulet /Lëndët (titujt):	Viti I 1. Bazat e biznesit 2. Mikroekonomia 3. Bazat e kontabiliteti 4. Shkrimi akademik 5. Matematika për biznes dhe ekonomi 6. Bazat e IT-së 7. Bazat e menaxhmentit 8. Makroekonomia 9. Bazat e financave 10. Statistika 11. Gjuha angleze I 12. Kontabiliteti financiar 13. Kontabiliteti I tatimeve 14. Menaxhimi I stresit dhe kohës Viti II

15. Mjedisit i biznesit
16. Financat e korporatave
17. Menaxhimi i operacioneve
18. Marketingu
19. Ekonomia e UE-së dhe e Kosovës
20. Biznesi elektronik
21. Financat personale
22. Tatimet dhe korporatat
23. Kontabiliteti menaxherial
24. Ndërmarrësia
25. Menaxhimi i burimeve njerëzore
26. Biznesi ndërkombëtar
27. Tregjet dhe institucionet financiare
28. Analiza statistikore
29. Komunikimi në biznes
30. Menaxhimi i dijës
31. Ekonomia monetare
32. Ekonomia e sigurimeve
33. Kontrolli dhe auditimi i brendeshëm
34. Menaxhimi i bazës së të dhënave

Viti III

35. Praktika dhe zhvillimi i karrierës
36. Gjuha angleze II
37. Fintech në Biznes
38. E drejta biznesore
39. Menaxhmenti strategjik
40. Gjuha Gjermane
41. Tregtia e jashtme
42. Sociologjia ekonomike

Specializimi në Administrim Biznesi

43. Menaxhimi i NVM-ve
44. Ekonometria
45. Menaxhimi i projekteve
46. Analiza mikroekonomike
47. Metodologjia e hartimit të diplomës
48. Lidershipi
49. Sisteme informacioni
50. Sjellje Organizative
51. Punimi i diplomës Bachelor

Specializimi në Banka dhe Financa

52. Ekonometria
53. Analiza dhe raportimi financiar
54. Financat ndërkombëtare

	55. Bankat dhe sigurimet 56. Metodologjia e hartimit të diplomës 57. Financa publike 58. Kontabiliteti banker dhe l sigurimeve 59. Menaxhimi i riskut të ndërmarrjes (ERM) 60. Punimi i diplomës Bachelor
Numri i vendeve të studimit:	250 në gjuhë shqipe 50 në gjuhë boshnjake
Udhëheqës i drejtimit/programit të studimit:	1. Prof. Asoc. Dr. Alma Shehu Lokaj 2. Prof. Dr. Husnija Bibuljica 3. Prof. Asoc. Dr. Vjosa Hajdari 4. Prof. Asoc. Dr. Suada Ajdarpašić 5. Prof. Ass. Dr. Driton Sylqa 6. Prof. Ass. Dr. Anita Cucović
Personeli i përhershëm shkencor/artistik: (Numri sipas kategorive të personelit)	5 profesorë të rregulltë, 5 profesorë të asocuar, 7 profesorë asistent dhe 10 asistentë.
Taksat e studimit:	Të përcaktuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Studimet janë falas. Vërejtje: Në rast kur përsëritet viti, bëhet pagesa sipas Udhëzimit Administrativ MASHTI Nr.09/2021 .
Mundësitë e punësimit pas diplomimit:	1. Sektori privat: - Menaxher apo asistent menaxher në kompani private - Specialist marketingu apo shitjesh - Koordinator projekteve apo burimesh njerëzore (HR) - Kontabilist apo financier - Analist performance apo operimesh 2. Sipërmarrje dhe start-up: - Themelues i një biznesi të ri (sipërmarrës) - Menaxher zhvillimi biznesi në start-up - Menaxher produkti apo inovacioni - Konsulent për rritje biznesi 3. Sektori publik dhe organizatat ndërkombëtare: - Specialist apo zyrtar administrativ në institucione publike - Koordinator projekteve zhvillimore - Ekspert i politikave ekonomike ose të biznesit - Konsulent për zhvillim lokal apo menaxhim publik 4. Institucionet bankare: - Specialist kredish apo klientësh - Analist financiar - Menaxher portofoli apo risku - Konsulent investimesh apo shërbimesh bankare 5. Konsulencë dhe analiza biznesi:

- Konsulent biznesi apo strategjie
- Analist të dhënash apo tregu
- Konsulent financiar apo i menaxhimit të kostove
- Trajner për zhvillim organizativ

6. Arsimin parauniversitar dhe universitar:

- Mësues i lëndëve ekonomike në shkolla të mesme (pas trajnimeve shtesë)
- Asistent mësimdhënieje apo kërkimi në universitet
- Administrator akademik apo koordinator programi

7. Institucione tjera në fushën e menaxhimit të biznesit:

- Punonjës apo koordinator në Oda Ekonomike / Dhoma Tregtie dhe Industrisë;
- Ekspert apo këshilltar në agjenci zhvillimore lokale dhe kombëtare;
- Konsulent në organizata joqeveritare (OJQ);
- Punonjës në inkubatorë biznesi apo qendra inovacioni;
- Përfaqësues apo koordinator projektsh në organizata ndërkombëtare;
- Asistent kërkimi apo ekspert analitik në institute ekonomike dhe kërkimore.